

RAPORTIT TË AUDITIMIT PËR FINANCIMIN E FUSHATËS ZGJEDHORE 25.04.2021

TE PARTIA NISMA THURJE

I. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

i. Kuadri Ligjor

- Ligji nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8580, datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike”, i ndryshuar;
- Ligji 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”;
- Ligji nr.25/2018, “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”;
- Udhezimi nr.13, datë 06.04.2021, të Komisionit Rregullator, “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar të subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore”.
- Udhezimi nr.14, datë 09.06.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për caktimin e kriterëve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të liçensuar (audituesve ligjor) dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore”.

ii. Standartet e zbatueshme

- Standartet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-te).
- Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK 10) për OJF-të.

B. OBJEKTII I AUDITIMIT

i. Kontrata e shërbimit

Raporti i auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet e datës 25.04.2021, të Partia Nisma Thurje, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, u hartua mbi bazën e kontratës së shërbimit të nënshkruar me Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve nr. Prot. nr.6511 datë 21.09.2021. Objekti i kësaj kontrate është kryerja e auditimit ligjor të detyrueshëm të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet 2021, nga subjektet zgjedhore në përputhje me Kodin Zgjedhor, i ndryshuar, Ligjin nr.8580, të datës 17.02.2000 “Për Partitë politike”, i ndryshuar, Ligjin nr. 10091, të datës 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar” dhe Ligjin nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

Neshat Maze/Auditues Ligjor

Rr.Dibres, Pll.120; Ap.6 Tirane; Mob. +355 (0)67 20 79 155
E-mail: lireng.auditing@gmail.com ; neshatmaze@hotmail.com

ii. Vendimi i KQZ-së

Gjithashtu, raporti për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet 2021, të datës 25.04.2021, te Partia Nisma Thurje u hartua mbi bazën e vendimit nr.426 të datës 12.07.2021 “Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (auditues ligjor), të cilët do të kryejnë auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore për fushatën zgjedhore, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.04.2021” .

iii. Përgjegjësitetë respektive të palëve, Partia Nisma Thurje, subjekt zgjedhor në zgjedhjet e datës 25.04.2021 dhe Neshat Maze, Auditues Ligjor

a. Përgjegjësia e Drejtimit dhe e Personave të Ngarkuar me Qeverisjen

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të deklaratave financiare që japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë në përputhje me Ligjin nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare“, Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK-te) dhe për kontrollin e brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga Drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e deklaratave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

Referuar nenit 92/6, pika 2 dhe 3 e Kodit Zgjedhor thuhet se:

- Subjektet zgjedhore duhet të vënë në dispozicion të auditit të emeruar nga KQZ-ja cdo informacion, dokument apo të dhënë, që ka të bëjë me financimin dhe shpenzimet e fushatës zgjedhore.
- Subjektet zgjedhore që auditohen duhet të vënë në dispozicion cdo informacion që disponojnë nga bankat, institucione apo persona të tretë që kanë lidhje me auditimin.

b. Përgjegjësia e Audituesit Ligjor

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto deklaratat financiare bazuar mbi auditimin tonë. Ne kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të përfitojmë siguri të arsyeshme që deklaratat financiare nuk kanë pasaktësi materiale. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi për shumat dhe informacionet e paraqitura në deklaratat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditusit, përfshirë dhe vlerësimin e rrezikut për pasaktësi materiale në deklaratat financiare, si rezultat i mashtrimit apo gabimeve. Në bërjen e këtyre vlerësimeve mbi rrezikun, audituesi konsideron kontrollin e brendshëm, si procedura auditimi të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit zgjedhor. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin dhe përshtatshmërinë e parimeve kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të deklaratave financiare. Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë, ofrojnë baza të arsyeshme për dhënien e opinionit tonë të auditimit.

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse deklaratat për raportimet financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk

Neshat Maze/Auditues Ligjor

Rr.Dibres, Pll.120; Ap.6 Tirane; Mob. +355 (0)67 20 79 155
E-mail: lireng.auditing@gmail.com ; neshatmaze@hotmail.com

është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve, do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë në vendimet e përdoruesve të marra bazuar në këto deklaratime dhe raporte financiare.

Audituesi Ligjor duhet të hartojë Raportin e Auditimit në përputhje me ligjin nr.10091, datë 05.03.2009, “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe Kontabilistit të Miratuar”, ligjin nr.8580, datë 17.02.2000, “Për Partitë Politike”, ndryshuar dhe ligjin nr.25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” si dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre.

Audituesi Ligjor do të auditojë në mënyrë specifike:

- Raportet Financiare (formatin tip) të zgjedhjeve sipas modelit të KQZ-së, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit zgjedhor të pavarur për fushatën zgjedhore;
- Hapjen e llogarive të posacme bankare nga subjekti zgjedhor për fushatën në momentin e regjistrimit sipas nenit 64 të Kodit Zgjedhor dhe derdhjen e të gjitha dhurimeve me vlerë më të madhe se 50.000 leke në këto llogari të posacme sipas nenit 92/2, pika 2 e Kodit Zgjedhor;
- Transaksionet financiare të kryera për periudhën 6 muaj para fushatës dhe gjatë fushatës zgjedhore, si dhe në çdo moment tjetër që kanë lidhje me fushatën nga persona fizikë ose juridikë, me qëllim evidentimin e transaksioneve të pajustificuara që mund të jenë përdorur për financim të paligjshëm të fushatës zgjedhore;
- Donacionet, huatë apo kreditë që i jepen subjektit zgjedhor për fushatën zgjedhore mund të behen vetëm nga persona fizike ose juridike vendas sipas nenit 92/1, pika 1 e Kodit Zgjedhor;
- Regjistrimi në një regjistër të posaçëm miratuar si model me vendim të KQZ-së të fondeve të përfituara nga çdo person fizik ose juridik si dhe të dhëna të tjera që lidhen me identifikimin e qartë të dhuruesit sipas nenit 92/2, pika 1 e Kodit Zgjedhor;
- Respektimi i kufirit maksimal të marrjes së një donacioni, kredie apo huaje e cila nuk mund të jetë më e madhe se 1 milion leke sipas nenit 92/1, pika 2 e Kodit Zgjedhor;
- Zbatimin e çdo dispozite ndaluese për financimin e fushatave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe në ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, “Për Partitë Politike”, i ndryshur;
- Dokumentimin e shpenzimeve të subjekteve të treta në funksion të veprimtarive të fushatës së subjektit zgjedhor dhe përputhjen e tyre me legjislacionin tatimor;
- Vleresimi i dhurimeve në natyrë;
- Respektimin e kufirit maksimal të shpenzimeve të fushatës zgjedhore sipas nenit 92/2, pika 4 e Kodit Zgjedhor ku thuhet se shuma e shpenzimeve të bëra nga një subjekt zgjedhor në një fushatë zgjedhore nuk duhet të jetë më shumë se 3 herë më e madhe se shuma me e lartë që ka marrë një subjekt zgjedhor nga fondet publike për qëllime zgjedhore ;
- Gjetjet e evidentuara gjatë procesit të monitorimit dhe çështjeve të shqyrtuara në funksion të raportit të auditimit.

Neshat Maze/Auditues Ligjor

Rr.Dibres, Pll.120; Ap.6 Tirane; Mob. +355 (0)67 20 79 155

E-mail: lireng.auditing@gmail.com ; neshatmaze@hotmail.com

- Të dhënat e raporteve financiare të subjektit zgjedhor do të krahasohen me gjetjet dhe përfundimet në raportin e auditimit ;
- Në përfundim do të paraqesim një raport për KQZ-në.

A. PREZANTIMI I SUBJEKTIT ZGJEDHOR TEK AUDITUESI LIGJOR

i. Prezantimi i subjektit zgjedhor

Partia Nisma Thurje është një parti politike me seli në adresën: Rruga “Abdyl Frasheri”, Tirane. Kryetar i Partisë N.TH është Z. Endrit SHABANI.

- i. Forma e organizimit dhe menaxhimit është konform ligjit Nr. 8580, datë 17.2.2000 “Per partite politike”. Organet e saj janë asambleja kombëtare, kryesia, sekretariatet dhe Kryetari, në parimin primus interparis. Organi më i lartë është asambleja e antareve, e cila ka gjithë atributet mbi rregullat, procedurat dhe organet e partisë.
- ii. Partia Nisma Thurje menaxhimin financiar e kryen teresisht nga qendra e saj.
- iii. Deget e saj në rrethë nuk kryejnë veprime financiare. Strukturat e qarqeve janë struktura politike jo administrative
- iv. Organizimi është menduar pa dege në qarqe, porse organizimi në qarqe është menduar përmes grupeve të socializimit, të cilat kryejnë misionin e shpërndarjes së linjës dhe qëndrimeve politike, si dhe organizimin e aktiviteteve.

Burimet financiare janë:

- Dhurimet në mjete monetare dhe në natyrë;
- Çdo e ardhur tjetër që nuk bie në kundërshtim me legjislacionin për financimin e partive politike.

B. PARAQITJA E RAPORTIT DHE STRUKTURA E TIJ

- i. Struktura e raportit të auditimit – kërkesat formale, të ardhurat dhe shpenzimet
Shpenzimet e fushatës zgjedhore 2021 janë në shumën 500,000 leke dhe janë përballuar nga financimet e kandidatëve.
- ii. Organizimi i takimeve dhe komunikimeve me subjektin zgjedhor

Pas raportimit financiar të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore 2021 të subjektit zgjedhor PNTH pranë KQZ-se, në fillim procedurat për kryerjen e auditimit ligjor.

Gjatë periudhës së auditimit kemi organizuar takime me financiarin e PNTH i cili na dorëzoi raportin financiar për fondet e fushatës zgjedhore si dhe na disponoi në ambjentet e selisë së Partisë dokumentacionin financiar që lidhej me auditimin e fondeve të fushatës zgjedhore.

Neshat Maze/Auditues Ligjor

Rr.Dibres, Pll.120; Ap.6 Tirane; Mob. +355 (0)67 20 79 155
E-mail: lireng.auditing@gmail.com ; neshatmaze@hotmail.com

iii. Paraqitja e përgjithshme në lidhje me raportin e financimit të fushatës zgjedhore të kontrolluar: nëse është ose jo në përputhje me kërkesat e raportimit.

- Raporti i financimit të fushatës zgjedhore është në përputhje me kërkesat e raportimit. Te ardhurat dhe shpenzimet janë pasqyruar drejtpërdrejt sipas natyrës dhe destinacionit të tyre. Raporti i financimit të fushatës është bazuar në Ligjin 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”;

II. KËRKESAT FORMALE

A. PËRMBLEDHJE

1/ Data e dorëzimit			
	a) dorëzim në formë elektronike	Po / Jo	Datë 12.09.2021
	b) dorëzim fizik	Po / Jo	Datë 12.09.2021
2/ Nënshkrimi			
	Nënshkrimi	Po / Jo	Datë 12.09..2021
3/ Llogaria bankare e veçantë / Personi përgjegjës i financës			
	a) evidenca e hapjes së llogarisë bankare	Po / Jo	Nuk ka
	b) Dokumenti i lëvizjeve në llogarinë bankare (bank statement) që mbulon periudhën e fushatës	Po / Jo	
	c) identiteti i personit përgjegjës të financës	Po / Jo	Panajot SOKO

B. ANALIZA

a/ Llogaria bankare e veçantë

- **A është unike llogaria bankare (vetëm për qëllimin e fushatës zgjedhore) ?**
 - o PNTH nuk ka hapur llogari bankare
 - o Nuk ka ndonjë llogari bankare tjetër, që është përdorur për të marrë financime publike dhe për të paguar shpenzimet.
 - o Raporti i financimit të fushatës zgjedhore nuk rezulton me tepricë në masën e financimit të marrë nga donatorët .
- **A është siguruar i gjithë informacioni?**
 - o Është siguruar informacioni në lidhje me lëvizjet bankare që kanë të bëjnë me fushatën zgjedhore për periudhën 3 muaj para dhe pas datës së zgjedhjeve 25.04.2021

b/ Personi përgjegjës për Financën

- **Identiteti i personit përgjegjës për financën:**
 - o Personi përgjegjës për financat e partisë është z.Panajot Soko , nuk është punonjës i regjistruar administratës.
 - o Çështje të mospërputhjeve të mundshme nuk ka.

Neshat Maze/Auditues Ligjor

Rr.Dibres, Pll.120; Ap.6 Tirane; Mob. +355 (0)67 20 79 155
E-mail: lireng.auditing@gmail.com ; neshatmaze@hotmail.com

- Përgjegjësi për përgatitjen dhe nënshkrimin e raportit të financimit të fushatës zgjedhore:

- Nënshkrimi i raportit të financimit të fushatës zgjedhore është bërë nga financieri i PNTH z.Panajot Soko.
- Përgatitja e të gjithë dokumenteve mbështetëse është si më poshtë :

	a) bosh/mungon informacioni	Jo		500 000	
	b) dokumentacioni (shqyrtim i shpejtë)				
		<i>Të Ardhurat</i>			
			Financime publike		
			Donacione private		400000
			Financim nga burimet e veta të partisë		
			Huatë/Kreditë		
			Financim nga kandidati		100000
					500 000
		<i>Shpenzimet</i>			
			Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës		
			Materialet promovuese		
			Media		500 000
			Sondazhe të Opinioneve Publike		
		Botime			
		Transporti			
		Konsulenca			
		Reklamime në ambiente të hapura			
		Administrative dhe të përgjithshme			

III. TË ARDHURAT

A. PËRMBLEDHJE

		Sipas raportit të financimit të fushatës zgjedhore	Sipas auditimit të kryer
1/ Financimi publik			
	Shuma e pagesës paradhënie		0
	Data e tranfertës		0
	Shuma e pagesës së marrë pas zgjedhjeve		0

Neshat Maze/Auditues Ligjor

Rr.Dibres, Pll.120; Ap.6 Tirane; Mob. +355 (0)67 20 79 155
E-mail: lireng.auditing@gmail.com ; neshatmaze@hotmail.com

	Data e transfertës		0
	Shuma e financimit publik e kthyer, nëse ka		0
	Data e transfertës		0
2/ Donacionet private			
	Shuma e përgjithshme e raportuar	500 000	500 000
	Shuma e donacioneve në para		
	Shuma e donacioneve në natyrë	500 000	500 000
	Përgatitet një listë e donatorëve		Po
	Përfshihen të gjitha dokumentet e lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement)		
	Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) (shuma)		
	Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) (data)		
	Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) (donatori)		
	Përputhshmëria mes çdo donacioni në natyrë të raportuar dhe vlerës së tregut (donatori / data)		
	A përputhen shifrat në total (të përgjithshme)?		
	Respektimi i kufirit të donacionit		Po
3/ Financimi nga burimet e vetë partisë			
	Shuma e përgjithshme e raportuar		
	Shuma e përgjithshme e raportuar (Zyra Qendrore)		
	<i>Kuotat e anëtarësisë</i>		
	<i>Botimet</i>		
	<i>Shtypshkronja</i>		
	<i>Marrje me qera</i>		
	Shuma e përgjithshme e raportuar (degët lokale)		
	<i>Kuotat e anëtarësisë</i>		
	<i>Botimet</i>		
	<i>Shtypshkronja</i>		
	<i>Marrje me qera</i>		
	Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement)(shuma)		
	Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në		

Neshat Maze/Auditues Ligjor

Rr.Dibres, Pll.120; Ap.6 Tirane; Mob. +355 (0)67 20 79 155
E-mail: lireng.auditing@gmail.com ; neshatmaze@hotmail.com

	Ilogaritë bankare (bank statement) (data)		
4/ Huatë/Kreditë			
	Shuma e përgjithshme e raportuar		
	Shuma / shuma e huasë / kredisë (për çdo kredi / hua)		
	Data e huasë / kredisë dhe data e shlyerjes (për çdo kredi / hua)		
	Paraqitja e dokumenteve mbështetëse (kontratat për secilën kredi / hua)		
5/ Marrja/Arkëtimi i të ardhurave			
	Të gjithë të ardhurat në para të marra / të mbledhura përmes llogarisë specifike.	Jo	Nuk ka llogari te veçante

B. ANALIZA

a/ Financimi publik

- Raporti i financimit të fushatës zgjedhore është i balancuar. Shpenzimet e fushatës nuk janë perballuar nga fondet publike. Nuk ka shuma të marre paradhenie.

b/ Financimi nga burimet jo publike

- Kontrolli i identitetit të donatorëve dhe lejueshmëria e çdo donacioni të deklaruar.
- Për sa i përket kufirit të shumës së lejuar për donacione sipas Kodit Zgjedhor ai është zbatuar. .
- Financime nga burimet jo publike të palejuara, nuk ka. Nga inspektimi i dokumentacionit financiar dhe transaksioneve financiare, nuk u identifikuan transaksione të pajustificuara që mund të jenë përdorur për financim të paligjshëm të fushatës zgjedhore.

Kontributet në natyrë

PNTH ka kontribute dhurime në natyrë në vlerën 500 000 leke, të cilat përbëhen nga shpenzime për reklama në rrjetet sociale, si Facebook, Instagram,

c/ Financimi nga burimet e vetë partisë politike

- **Klasifikimi sipas zërave i të ardhurave nga burimet e vetë partisë**
 - o **Transferte nga llogaria e Partisë.** Në këtë rast të ardhurave nga burimet e vetë Partisë nuk ka,
- **Klasifikimi i të ardhurave që merren nga burimet e vetë partisë për secilin zë të deklaruar sipas emrit të degës**
 - o Te ardhurat që merren nga burimet e vetë Partisë janë të Zyres Qendrore.
- **Përputhshmëria mes natyrës dhe shumës së të ardhurave të deklaruar dhe deklarimit bankar (bank statement) (mund të përdoret edhe termi “nxjerrje e llogarisë”)**

Shuma e të ardhurave të deklaruara janë sipas pagesave të donatorit për kompaninë Facebook.

d/ Huatë/Kreditë

Neshat Maze/Auditues Ligjor

*Rr.Dibres, Pll.120; Ap.6 Tirane; Mob. +355 (0)67 20 79 155
E-mail: lireng.auditing@gmail.com ; neshatmaze@hotmail.com*

- Nuk jane marre hua per financimin e shpenzimeve te fushates zgjedhore.

IV. SHPENZIMET

A. PËRMBLEDHJE

Shuma e përgjithshme e raportuar		500 000					
Respektimi i kufirit të shpenzimit		Po					
Shpenzimet e kryera nga Zyra Qendrore e partisë							
	Shpenzimet zgjedhore të deklaruar në raportin e financimit të fushatës zgjedhore	Faturat e paraqitura	Faturat e Përgjithshme	Dokumente mbështetëse që mungojnë	Shpenzime të papaguara	Mospërputhje në lidhje me dokumentet e paraqitura nga furnitorët	Shuma e përgjithshme e shpenzimeve zgjedhore sipas auditimit
Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës							
Materialet promovuese							
Media	500 000	Indikatore elektronik e te postimit	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka		500 000
Sondazhet e opinionit publik							
Botimet							
Transporti							
Konsulenca							
Reklamat në ambientet e jashtme							
Administrative dhe të përgjithshme							
Shpenzimet e bëra nga degët e partisë							

Neshat Maze/Auditues Ligjor

Rr.Dibres, Pll.120; Ap.6 Tirane; Mob. +355 (0)67 20 79 155
E-mail: lireng.auditing@gmail.com ; neshatmaze@hotmail.com

	Shpenzimet zgjedhore të deklaruar në raportin e financimit të fushatës zgjedhore	Faturat e paraqitura	Faturat e Përgjithshme	Dokumente mbështetëse që mungojnë	Shpenzime të papaguara	Mospërputhje në lidhje me dokumentet e paraqitura nga furnitorët	Shuma e përgjithshme e shpenzimeve zgjedhore sipas auditimit
Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës							
Materialet promovuese							
Media							
Sondazhet e opinionit publik							
Botimet							
Transporti							
Konsulenca							
Reklamat në ambientet							
Administrative dhe të përgjithshme							
Shpenzimet zgjedhore							
Të gjitha shpenzimet zgjedhore të bëra janë paguar përmes një llogarie të veçantë							Nuk ka llogari të veçantë

B. ANALIZA

a/ Respektimi i kufirit të shpenzimeve:

Eshte respektuar kufiri i shpenzimeve të fushatës në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor.

b/ Analiza e të gjithë shpenzimeve të deklaruar dhe klasifikuara sipas degës së partisë dhe kategorisë, gjate fushatës zgjedhore te dates 25.04.2021.-

Media (pagesa media online) 500 000 leke

Te gjitha fondet dhurim ne natyre jane financime jo publike , nga kandidatet e kesaj partie ,,

Nga ky subjekt nuk rezulton :

- Nuk ka tejkalim te shpenzimeve te kryera nga PNTH, shpenzime(Dhurime ne natyre) te financuara nga vete kandidatet.

Neshat Maze/Auditues Ligjor

Rr.Dibres, Pll.120; Ap.6 Tirane; Mob. +355 (0)67 20 79 155
E-mail: lireng.auditing@gmail.com ; neshatmaze@hotmail.com

-
- Pasqyrat e deklarimit te fondeve te perfituara dhe te shpenzuara qe na jane vendosur ne dispozicion me posten elektronike dhe te printuara ,
jane pa siglen e depozitimit ne KQZ.

V. PËRFUNDIMI

A. SINTEZA

- Përmbledhja e gjetjeve dhe përfundimeve

Gjatë procesit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara u konstatuan gjetja: Pasqyrat e deklarimit te fondeve te perfituara dhe te shpenzuara qe na jane vendosur ne dispozicion me posten elektronike dhe te printuara jane pa siglen e depozitimit ne KQZ.

VI. PËRFUNDIMI

Opinionit pa rezervë

Ne kemi audituar fondet e akorduara dhe te shpenzuar per fushaten zgjedhore per zgjedhjet parlamantare te dates 25.04.2021 te partise Nisma Thurje si edhe shënimet për akordimin dhe shpenzmini e këtyre fondeve, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, *(pervec gjetjes qe nuk ndryshon ne opinion)* fondet e akorduara dhe te shpenzuar per fushaten zgjedhore per zgjedhjet parlamantare te dates 25.04.2021 te partise Nisma Thurje në këtë datë, janë në përputhje me Standardet Kombetare te Kontabilitetit .

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me SKK. Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për këte sherbim*. Ne jemi të pavarur nga subjekti në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e fondet e akorduara dhe te shpenzuar per fushaten zgjedhore per zgjedhjet parlamantare te dates 25.04.2021 te Partise Nisma Thurje dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Neshat Mazaj

Auditue Ligjor

Tirane ,me 29.10.2021

Neshat Maze/Auditues Ligjor

*Rr.Dibres,Pll.120;Ap.6 Tirane; Mob. +355 (0)67 20 79 155
E-mail:lireng.auditing@gmail.com ;neshatmaze@hotmail.com*

Shenime. Bashkengjitur do të gjeni:

- ✓ Lista e donatorëve
- ✓ Pasqyrat e Raportimeve Financiare (Formati tip i raportuar nga Partia,dorëzuar ne KQZ.)

Tabela e fondeve të përfituara nga Partia Nisma Thurje prej personave juridikë ose fizikë vendas për zgjedhjet e datës 25.04.2021 për Kuvendin e Shqipërisë

	Pershkrimi i dhurimit	Vlera ne Leke	Identiteti i plote i dhuruesit	NIPTI/Karta identitetit	Data e dhurimit	Numri i llogarise
1	Ne natyre	400 000	Panajot Soko	H90101209O	4/01/2021	
2	Ne natyre	100 000	Gjelosh Bibaj	H50933067L	4/01/2021	